



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN "TIRANË"**

VENDIM

Nr.2 datë 07.12.2017

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS-SHPIMI, SAUK I VJETËR BASHKIA TIRANË,
SUBJEKTI "NEKI ELEZI" PERSON FIZIK**

Në zbatim të Ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2; ligjit 111/2015 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar" neni 8 pika 1, Vendimit Nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

Miratimin e lejes për hapjen e një pus shpimi për subjektin, "Neki Elezi" person fizik, nga Shpuesi profesionist Artur Shiba, Sauk i vjetër bashkia Tiranë .

1.Koordinatat e vendodhjes së pusit dhe parametrat teknikë :

X=4574531 Y=4402568 Z=160 M

- a. Thellësia e parashikuar 25 m
- b. Kapaciteti i parashikuar Q= 0.01 l/s
- c. Diametri i shpimit 800 mm

2.Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin e këtij Vendimi

3. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHEM-ERZEN

SEKRETAR

Shpëtim MEDIU

KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

